



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr 1025/13 prot

Datë 15 / 05 / 2019

VENDIM
Nr 7 datë 9 / 5 / 2019

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.32 DATË 27.11.2018 TË KËSHILLIT TË
BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN PËR "MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË
PUS-SHPIMI, RRUGA SKËNDERBEJ, DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT
DIPLOMATIK, PËR QËLLIME SANITARE"**

Në zbatim të ligjit nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” të ndryshuar neni 56 pika 1; të ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 136, pika 4; vendimit nr. 416 datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, vendimit nr.221 datë 26.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor”, vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullore “Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, me shkresën nr.559/14 prot, datë 26.03.2019, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik kërkon ndryshim të shpuesit profesionist dhe me propozim të ZABU Ishëm-Erzen-Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

Pika 1 e Vendimit nr.32 datë 27.11.2018 të KBU Ishëm-Erzen “Për Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi, rruga Skënderbej, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për qëllime sanitare” ndryshon si më poshtë vijon:

- 1.“Miratimin e lejes për hapjen e një pus-shpimi për qëllime sanitare, për subjektin “Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik”, ndërmarje shtetërore, nga shpuesi profesionist **"Hysi-2F" shpk**. Ndryshimin e shpuesit Profesionit nga “Hidrotek-KO” shpk në "Hysi- 2F"shpk.
2. Këtij vendimi i bashkëlidhet vendimi nr.32 datë 27.11.2018 i KBU Ishëm-Erzen.
3. Ngarkohet ZABU Ishëm Erzen-Mat për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Adrian SHITINO



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

